

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7020
E premte, 13 tetor 2023
Çmimi 0.50

Kurti: Ka rrezik të përsëritjes së sulmeve të dhunshme nga strukturat kriminale serbe



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



KRYEMINISTRI EDI RAMA MBAN FJALIM TË FUQISHËM PËR KOSOVËN NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

KOSOVA PO HUMBET SHANSIN HISTORIK NGA MARRËVESHJA FRANKO-GJERMANE



- Hashim Thaçi është një shqiponjë që edhe në kafazin e Hagës i pengon jo pak koka politike

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se Kosova është duke e humbur shansin historik që ia garanton marrëveshja franko-gjermane. Rama në Kuvendin e Shqipërisë ka thënë se pozicioni i vetëdobësuar diplomatik i Kosovës në

sytë e ShBA-së dhe BE-së po ia bëjnë të vështirë Shqipërisë përpjekjet për ta ndihmuar në zgjidhjen e situatës në veri. Në këtë kontekst, Rama ka thënë se Kosova duhet të reflektojë për kritikën dhe kërkesat e Brukselit dhe të Uashingtonit. Rama ka shprehur

qëndrim kritik edhe ndaj akuzave nga zyrtarë të ndryshëm në Kosovë dhe Shqipëri për qasjen e tij në raport me zhvillimet në veri. Po ashtu, ai u ka dalë në mbrojtje Hashim Thaçit dhe Ramush Haradinajt për akuzat bërë ditët e fundit

SHQIPËRIA TREGOI KURRIZ SHTETËROR NË RASTIN GOXHAJ DHE BELERI



Shkruan: Behxhet SH. SHALA - BAJGORA

DEPUTETËT E PUSHTETIT E BOJKOTUAN SEANCËN NË TË CILËN PRITEJ TË VOTOHEJ REZOLUTA PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË POLICISË



AKTUALE



BLINKENI NË IZRAEL: SHBA-ja DO TË JETË GJITHMONË PËRKRAH JUSH

KRYETARËT E KRYEQYTETEVE TË RAJONIT MBLIDHEN NË TIRANË: TRANSFORMIMI DIGJITAL, I DOMOSDOSHËM

TRI HERË DËSHTOI KONSTITUIMI I KOMISIONIT HETIMOR PËR REZERVAT SHTETËRORE, JA DEPUTETËT QË PO E SABOTOJNË PUNËN

EKONOMI



RIZVANOLLI: SERBIA PO E BOJKOTON UDHËRRËFYESIN PËR ENERGINË

GUVERNATORI ISMAILI ZHVILLON TAKIME ME ZYRTARË TË LARTË TË FMN-së, TË BB-së DHE TË IFC-së

SPORT



FITORE E MADHE E SHQIPËRISË NDAJ ÇEKISË - KUQEZINJTË ME NJË KËMBË NË EURO 2024

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji biznesi.com
info@kolegji biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Osmani: Nga Izraeli janë evakuuar 60 shtetas maqedonas

SHKUP, 12 TETOR - Gjashtëdhjetë shtetas të Maqedonisë së Veriut janë evakuuar nga Izraeli që nga fillimi i sulmit masiv të militantëve të Hamasit, të shtunën, më 7 tetor, bëri me dije ministri i Punëve të Jashtme i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani. Ai tha se autoritetet kanë regjistruar rreth 150 shtetas të Maqedonisë së Veriut në qytete të ndryshme të Izraelit

dhe në territoret palestineze. Por, ky numër mund të arrijë deri në 200 persona pasi disa nuk janë paraqitur për identifikim në thirrjen e autoriteteve të Shkupit. Të shtunën, sipas Osmanit, pritet të kthehen në Shkup edhe 90 të tjerët, të cilët janë duke komunikuar me shtabin e krizës të formuar menjëherë pas shpërthimit të konfliktit të Izraelit. Shefi i diplomacisë

maqedonase tha se ambasada në Kajro është duke komunikuar me dy persona të tjerë që ndodhen brenda zonave të rrezikuara të Gazës, të izoluar nga Izraeli, pasi nuk arritën të dilnin para mbylljes së pikës së vetme kufitare me Egjiptin. "Situata atje është shumë e ndryshueshme dhe vlerësojnë se janë të ekspozuar ndaj rrezikut. Ne po punojmë, gjithashtu, me autoritetet në

Egjipt për t'i liruar ata dhe më pas do ta organizojmë transportin nga Egjipti. Mirëpo, për momentin, nuk kemi si t'i nxjerrim nga Gaza", tha Osmani. Disa nga shtetasit maqedonas që gjendeshin në zonat e rrezikuara në rajonin e Gazës të mërkurën në mbrëmje kanë arritur në Athinë prej nga me autobus janë transferuar në kufirin e Maqedonisë së Veriut. Sipas



Osmanit, fillimisht fokusi ishte identifikimi, kontaktimi dhe nxjerrja e qytetarëve nga zonat e rrezikuara dhe më pas transportimi i tyre në Tel Aviv.

Blinkeni në Izrael: ShBA-ja do të jetë gjithmonë përkrah jush

JERUSALEM, 12 TETOR - Sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, gjatë vizitës në Izrael, tha se Uashingtoni "gjithmonë" do ta mbështesë këtë shtet. Megjithatë, kryediplomati amerikan tha se palestinezët kanë "aspirata legjitime" që nuk përfaqësohen nga grupi militant i Hamasit. "Ju mund të jeni mjaftueshëm të fuqishëm që ta mbronin veten", tha Blinkeni gjatë takimit me kryeministrin e Izraelit, Benjamin Netanyahu, teksa konflikti në mes të Izraelit dhe Hamasit po vazhdon. "Por, për aq kohë sa të ekzistojë Amerika, nuk do të keni nevojë të jeni vetëm. Ne gjithmonë do të jemi përkrah jush".

Vizita e Blinkenit në Izrael është për ta shprehur solidaritetin e ShBA-së, pasi militantët e Hamasit më 7 tetor nisën sulmin më të madh ndaj Izraelit në vitet e fundit. Si pasojë e dhunës, 1 200 persona janë vrarë në Izrael.

Blinkeni, po ashtu, njoftoi se të paktën 25 amerikanë janë në mesin e viktimeve.

Presidenti amerikan Joe Biden ka deklaruar se mbështetja për



Izraelin është e palëkundur dhe nuk i ka bërë thirrje izraelit të frenohet kundër Hamasit. Por, Blinkeni la të kuptohet se eventualisht do të ketë nevojë

për një marrëveshje të paqes. "Kushdo që dëshiron paqe dhe drejtësi duhet ta dënojë sundimin e terrorit të Hamasit. Ne e dimë që Hamas nuk

përfaqëson popullin palestinez apo aspiratat e tyre legjitime për të jetuar me masa të barabarta të sigurisë, lirisë, mundësisë së drejtësisë dhe

dinjitetit", tha Blinken.

Sekretari Blinken premtoi se administrata Biden dhe Kongresi amerikan do të punojnë së bashku që të plotësohen kërkesat ushtarake për Izraelin. "Përderisa kërkesat e mbrojtjes së Izraelit rriten, ne do të punojmë me Kongresin që ato të plotësohen", tha ai.

Ndërkaq Netanyahu falënderoi ShBA-në për mbështetjen dhe tha se militantët e Hamasit duhet të trajtohen si militantët e Shtetit Islamik (IS). "Sikurse u shtyp IS-i, edhe Hamasi do të shtypet. Hamasi duhet të trajtohet njësoj sikurse është trajtuar IS-i", tha Netanyahu.

Në Gaza është raportuar për më shumë se 1 300 të vrarë.

Izraeli thotë se rreth 1 500 militantë të Hamasit u vranë brenda Izraelit dhe se qindra të vdekur brenda Gazës janë anëtarë të Hamasit.

Më 7 tetor grupi militant Hamas nisi sulmin më të madh ndaj Izraelit në vite, duke e sulmuar nga toka, ajri dhe deti. Izraeli u kundërpërgjigj me sulme të ashpra dhe po vazhdon ta bombardojë Gazën, territor ku jetojnë 2.2 milionë banorë.

Kërkohe krijimi i korridoreve humanitare në Gaza

GAZA, 12 TETOR - Këshilli Norvegjez për Refugjatët (KNR) i ka bërë thirrje të enjten komunitetit ndërkombëtar për krijimin e korridoreve dhe pauzave humanitare në mënyrë që të jetë i mundur dërgimi i ndihmave humanitare në Gaza. "Ne i bëjmë thirrje komunitetit ndërkombëtar që urgjentisht të ngulë këmbë në qasjen humanitare dhe mbrojtjen e civilëve", tha KNR-ja në një komunikatë të enjten. Më herët gjatë ditës, ministri i Energjisë i

Izraelit, Israel Katz, tha se rrethimi i Rripit të Gazës nuk do të përfundojë derisa Hamasi t'i lirojë të gjitha pengjet izraelite. Izraeli e nisi rrethimin e Rripit të Gazës të hënën, dy ditë pasi militantët e Hamasit i thyen barrierat kufitare dhe u futën në jug të Izraelit për ta kryer njërin prej sulmeve më vdekjeprurëse në historinë e Izraelit.

Së paku 150 pengje u dërguan në Gaza gjatë sulmit të Hamasit në fundjavë, ku mbetën të

vrarë mbi 1 200 izraelitë. Ushtria izraelite është duke bombarduar Gazën që nga dita e hënë, duke bërë që rreth 1 200 palestinezë të vriten gjatë kësaj periudhe.

Të mërkurën termocentrali i vetëm në Gaza mbeti pa karburant, që do të thotë se enklava me rreth 2.3 milionë banorë tani varet plotësisht nga gjeneratorët për furnizim me rrymë. "Në këtë çast, Gaza ka mbetur pothuajse pa karburant, ndërsa furnizimi me ilaçe dhe



ushqim është tejet i vogël. Kjo zonë e mbipopulluar është nën rrethim të plotë dhe bombardime të pareshtura nga Izraeli. Ne

duhet të jemi në gjendje të çojmë ndihma për të shpëtuar jetë për popullin e Gazës sa më shpejt që është e mundur", tha ky grup.

Deputetët e pushtetit bojkotuan seancën ku pritej të votohej rezoluta për mbështetje financiare për policinë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 TETOR - Kuvendi i Kosovës ka mbajtur të enjten seancë të jashtëzakonshme me vetëm një pikë të rendit të ditës: "Shqyrtimi i propozim-rezolutës për mbështetjen urgjente financiare të Policisë së Kosovës". Këtë rezolutë e ka propozuar PDK-ja dhe ka marrë mbështetjen e partive opozitare, LDK-së dhe AAK-së, ndërkaq grupi parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje nuk ka marrë pjesë në seancë. Po ashtu, as kabineti qeveritar nuk ishte i pranishëm në këtë seancë.

Me të filluar seanca, deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, adresoi kritika edhe në drejtim të kryeparlamentarit Glauk Konjufca. "Kryetar, nuk jeni krejt i pafajshëm në këtë ngjarje, sepse nuk jeni pa fuqi politike brenda subjektit tuaj politik. Mendoj se edhe për ju tani do të ishte mirë ose t'u bëni thirrje publike deputetëve të partisë suaj që të jenë këtu dhe t'i përkrahin kërkesat e policisë ose ta lironi karrigen dhe t'ia lironi një nënkryetari ta udhëheqë seancën...", ka thënë ajo, duke kërkuar nga Konjufca ta thërrasë shumicën parlamentare dhe ta shpërbëjë këtë kuvend. "Fitojini zgjedhjet edhe me 80 për qind a 90 për qind, s'ka problem, por që duhet të kthehet vullneti politik në duart e qytetarëve kjo është e padiskutueshme. Prandaj për procedurë të mëtejme kjo seancë



varet prej teje si kryesues ose si udhëheqës i kësaj seance", ka thënë Musliu.

Pas deklaratës së Musliut, Konjufca ua lironi vendin partive opozitare për ta udhëhequr seancën. Pas kësaj deputetët e liruuan sallën e Kuvendit, duke mos u mbajtur kjo seancë.

Grupi parlamentar i AAK-së, në lidhje me mospraninë e qeverisë Kurti dhe deputetëve të shumicës në Kuvendin e Kosovës, mori një aksion simbolik duke shpërndarë fletë të bardha me mbishkrimin: "E harruat policinë".

Deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka numëruar tri veprime të mazhorancës brenda dy jave, të cilat i ka quajtur të paprecedentë dhe që cenojnë demokracinë parlamentare dhe rendin kushtetues në Kosovë. "1. Seanca e jashtëzakonshme, e thirrur me 40 nënshkrime, pamundësohet nga mazhoranca me mungesë kuorumi. 2. Komisioni Hetimor Parlamentar, edhe ky i themeluar me 40 nënshkrime, pengohet që ta nisë punën. 3. Qeveria nuk përgjigjet në pyetjet parlamentare të opozitës, e cila gjë është detyrim kushtetues i

qeverisë ndaj Kuvendit", ka thënë Hoti.

Shefja e grupi parlamentar e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se qëllimi i PDK-së, e cila e ka thirrur këtë seancë, por edhe i AAK-së nuk ka të bëjë me gjendjen e policisë. "Që nga java e kaluar grupi parlamentar i PDK-së ka tentuar ta ndryshojë rendin e ditës në seancë për të futur një pikë që ka të bëjë me një rezolutë për kushtet për Policinë e Kosovës. Ne vlerësojmë se qëllimi i PDK-së dhe AAK-së që nuk votojnë asgjë në Kuvendin e Kosovës, pra marrëveshjet

ndërkombëtare dhe ligje me rëndësi jetike për qytetarët, nuk ka të bëjë me gjendjen e Policisë së Kosovës, por vetëm me argumentimin e tyre se qeveria nuk është e angazhuar sa duhet. Synimi i tyre është pushteti dhe jo interesi i shtetit", është shprehur Kusari-Lila në një konferencë për medie.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka reaguar për bojkotimin e seancës nga deputetët e pozitës. Krasniqi ka shkruar në "Facebook" se pushteti e do policinë vetëm për mburje dhe refuzon ta ndihmojë e ta forcojë. "Sot, për herë të dytë brenda një jave, Lëvizja Vetëvendosje kundërshtoi Rezolutën e propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës, e cila, me miratimin e saj, do ta ndihmonte shpejt dhe konkretisht Policinë e Kosovës. Është e mjerueshme dhe për keqardhje kjo qasje e pushtetit ndaj policëve tanë. Shpejt e harruan sakrificën e heroit Afrim Bunjaku dhe kolegëve të tij, të cilët çdo ditë e vënë jetën e tyre në rrezik për ta garantuar sigurinë e qytetarëve dhe sovranitetin e shtetit tonë", ka shkruar Krasniqi. Po sipas tij, PDK-ja nuk do të ndalet. "Ne do të insistojmë, përmes të gjitha mënyrave dhe mekanizmave, që këtë Rezolutë ta miratojmë. Shtesat për rrezikshmërinë, sigurimi shëndetësor dhe miratimi i Ligjit për Pensionim të Parakohshëm, janë më të paktat që meritojnë policët tanë", ka thënë Krasniqi.

Tri herë dështoi konstituimi i Komisionit Hetimor për Rezervat Shtetërore, ja deputetët që po e sabotojnë punën

PRISHTINË, 12 TETOR - Komisioni Hetimor Parlamentar në lidhje me procedurat për furnizimin dhe menaxhimin e rezervave shtetërore nuk ka mundur të konstituohet as të martën, për të tretën herë, për shkak të mospranisë së deputetëve të pozitës.

Eugen Cakolli nga KDI-ja ka treguar përmes një videomesazhi se kush janë gjashtë deputetët e pozitës të cilët e kanë sabotuar punën e Komisionit Hetimor për Rezervat Shtetërore. "Këtë javë ka dështuar për herë të tretë radhazi konstituimi i Komisionit Hetimor Parlamentar për rastin e rezervave shtetërore pavarësisht votës së 69 deputetëve për, një kundër dhe 6 abstenime. Sërish shkak i dështimit të mbledhjes

konstituive ishte mungesa e gjashtë deputetëve të shumicës parlamentare: Armend Muja, Driton Hyseni, Shqipe Meta-Isufi, Halil Thaçi, Salih Zyba, Erxhan Galushi që udhëhiqet nga LV-ja. Megjithatë fuqia politike në Kuvend nuk duhet të shndërrohet në arsye për qeverisje jotransparente e jollogaridhënese e cila saboton proceset parlamentare, që janë në funksion të qeverisjes së mirë e pa korrupsion. Vetëm duke mundësuar konstituimin e këtij komisioni dhe përmbushjen e mandatit të tij deputetët do të mund të kontribuojnë në heqjen e të gjithave dilemave mbi aferat potenciale korruptive dhe do të rritin besimin e publikut në institucione dhe në qeverisje", ka thënë Cakolli.

INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS





KRYEMINISTRI EDI RAMA MBAN FJALIM TË FUQISHËM PËR KOSOVËN NË KUVENDIN E SHQIPËRISË

Kosova po humbet shansin historik nga marrëveshja franko-gjermane

- Hashim Thaçi është një shqiponjë që edhe në kafazin e Hagës i pengon jo pak koka politike

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka thënë se Kosova është duke e humbur shansin historik që ia garanton marrëveshja franko-gjermane. Rama në Kuvendin e Shqipërisë ka thënë se pozicioni i vetëdobësuar diplomatik i Kosovës në sytë e ShBA-së dhe BE-së po ia bëjnë të vështirë Shqipërisë përpjekjet për ta ndihmuar në zgjidhjen e situatës në veri. Në këtë kontekst, Rama ka thënë se Kosova duhet të reflektojë për kritikën dhe kërkesat e Brukselit dhe të Uashingtonit. Rama ka shprehur qëndrim kritik edhe ndaj akuzave nga zyrtarë të ndryshëm në Kosovë dhe Shqipëri për qasjen e tij në raport me zhvillimet në veri. Po ashtu, ai u ka dalë në mbrojtje Hashim Thaçit dhe Ramush Haradinajt për akuzat bërë ditët e fundit

**EPOKA
ERE**

Lirim GECI

TIRANË, 12 TETOR - Kuvendi i Shqipërisë të enjten ka diskutuar për situatën në Kosovë, pas agresionit të Serbisë më 24 shator në veri të Kosovës, ku ka mbetur i vrarë rreshteri i policisë, Afrim Bunjaku, i cili është shpallur hero i Kosovës. Në këtë seancë është paraqitur edhe rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë, e cila dënon ashpër sulmin në veri të Kosovës.

Në fillim të debatit parlamentar, kryeministri i Shqipërisë ka mbajtur një fjalim, i cili ka zgjatur hiç më pak se 1 orë e 30 minuta. Në këtë fjalim Rama ka folur në detaje për situatën në Kosovë dhe rrugën se si duhet të ecet përpara. Rama ka thënë se pozicioni "i vetëdobësuar diplomatik i Kosovës" në sytë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) dhe Bashkimit Evropian (BE) po ia bëjnë të vështirë vendit të tij përpjekjet për të ndihmuar në zgjidhjen e situatës në veri të

Kosovës, duke iu referuar qëndrimeve të kryeministrit Albin Kurti. Ai ka treguar se bashkë me presidenten Osmani gjatë samitit të Komunitetit Politik Evropian në Granada të Spanjës kanë kërkuar nga liderët e pranishëm një qëndrim adekuat të BE-së për sulmin e ndodhur në Banjskë.

Rama ka potencuar se Serbia mban përgjegjësi të madhe për sulmin, meqë jo vetëm që nuk e ka dënuar agresionin, por e ka mbuluar atë edhe me flamurin

kombëtar të zisë. "Pozicioni i vetëdobësuar diplomatik i Kosovës në sytë e BE-së dhe ShBA-së dhe vetë viktimizimi diplomatik i Serbisë në ata sy, falë dhuratave politike të marra bujarisht nga gabimet e Prishtinës zyrtare, e bëjnë jo të lehtë këtë përpjekje nga ana jonë, të cilën e kemi vazhduar në çdo instancë dhe çdo rrethanë", ka thënë Rama.

Më tutje, Rama ka thënë se "Kosova po humbet shansin historik të marrëveshjes bazuar në planin franko-gjerman", si e vetmja mënyrë, sipas tij, për të bërë përparim. Ai ka thënë se Kosova duhet patjetër të reflektojë për kritikën dhe kërkesat e Brukselit dhe Uashingtonit. "Kosova duhet patjetër të reflektojë për kritikën dhe kërkesat e Brukselit dhe Uashingtonit. Ishte e papranueshme që deklarata të dilte, sikur asgjë tjetër nuk kishte ndodhur", ka thënë Rama, duke përmendur edhe fjalët që ish-presidenti amerikan,

Bill Clinton, ia ka thënë për Kosovën gjatë vizitës së fundit në Shqipëri. "Kur Clintoni erdhi në Tiranë më tha: 'Thuaju miqve të mi në Prishtinë të mos e humbin shansin e madh të marrëveshjes franko-gjermane. Tregoju nga ana ime se si e humbi Jaser Arafati mundësinë e artë të paqes kur e kishte mbi tavolinën e Zyrës Ovale dokumentin e marrëveshjes më të mirë që është shkruar ndonjëherë për atë konflikt'", ka thënë Rama.

Në fjalën e tij, Rama është ndalur edhe te kritikën dhe akuzat në adresë të tij për KFOR-in dhe veriun. "E kam thënë në samitin e NATO-s mbi domosdoshmërinë e marrjes së kontrollit të veriut të Kosovës nga KFOR-i, fokusimi te suksesi i planit franko-gjerman dhe dhënies drejtim të asociacionit me shumicë serbe se është një nyje që nuk duhet mbajtur si litar në këmbë, që e pengon Kosovën në rrugën e saj dhe largon objektivin për t'u bërë pjesë e OKB-së, NATO-s, BE-së",

Kryetarët e kryeqyteteve të rajonit mbledhen në Tiranë: Transformimi digjital, i domosdoshëm

Tiranë, 12 tetor - Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal (RCC), së bashku me Bashkinë e Tiranës dhe Rrjetin e Asociuar të Autoriteteve Lokale në Evropën Juglindore (NALAS), kanë organizuar të enjten në Tiranë Forumin e parë të Vetëqeverisjes Vendore me temë "Unlocking the Future: Innovate, Eco-vate, Elevate - Western Balkans Unite for Smart Cities". "Nisja e dialogut të strukturuar rajonal me vetëqeverisjen lokale, në prag të Samitit të Procesit të Berlinit, në mes të diskutimeve të rivitalizuara për integrimin e përshtetshëm të rajonit tonë në BE, e për planin e guximshëm për ringritjen ekonomike, por edhe pas krizës së zgjatuar energjetike - është një mundësi e mirë, në kohën e duhur, për t'i hapur rrugën lokalizimit dhe decentralizimit të zbatimit të Agjendës së Gjellbër për Ballkanin Perëndimor. Ky Forum, në bashkëpunim edhe me forumin e shoqërisë civile që iniciuam në fillim të këtij viti, mund të jetë një nxitës i mirë për përkthimin e strategjive globale dhe rajonale në veprime konkrete lokale", ka theksuar sekretarja e përgjithshme e RCC-së, Majlinda Bregu, në fjalën e saj të hapjes.

Forumi "Unlocking the Future: Innovate, Eco-vate, Elevate - Western Balkans Unite for Smart

Cities" shënon fillimin e një dialogu të strukturuar rajonal midis vetëqeverisjeve lokale nga Ballkani Perëndimor, me synimin për ta nxitur zbatimin e Agjendës së Gjellbër të Ballkanit Perëndimor, në nivel lokal. "Qytetet janë të parat që ndeshen dhe ndiejnë ndikimet mjedisore, nga ndotja e ajrit, menaxhimi i mbetjeve si dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike. Ato konsumojnë më shumë se 65 % të energjisë së botës dhe janë përgjegjës për mbi 70 % të emetimeve globale të karbonit. Trajtimi i këtyre çështjeve kërkon ndryshime thelbësore në infrastrukturën tonë urbane, sistemet e transportit dhe burimet e energjisë, të cilat janë përpjekje komplekse dhe të kushtueshme. Prandaj është e domosdoshme që qytetet dhe rajonet të mbështeten për përshtetshëm të tranzicionit të tyre drejt krijimit të mjedisve urbane miqësore me ambientin dhe digjitale. Forumi dhe diskutimet që do të zhvillojmë këtu kanë synim forcimin e përpjekjeve tona kolektive për inovacion dhe përmirësim. Bashkëpunimi midis pushtetit vendor dhe atij qendror, angazhimi me shoqërinë civile dhe sektorin privat dhe rininë tonë të talentuar sipërmarrëse, mund të sjellë ekspertizë dhe burime të ndryshme në tryezë dhe ta



ndihmojë rajonin tonë të kalojë drejt një të ardhmeje më të gjellbër dhe digjitale", ka deklaruar Bregu. Krahas Bregut, fjalën e hapjes e mbajtën Arbjan Mazniku, ministër për Pushtetin Vendor të Shqipërisë, Luigi Soreca, ambasadori i BE-së në Shqipëri, Mehmet Ergün Turan, president i NALAS dhe kryetar i Bashkisë së Shkupit, Përparim Rama, kryetar i komunës së Prishtinës, Samir Avdiq, nënkryetar i Bashkisë së Sarajevës dhe Luka Rakçeviq, nënkryetar i Bashkisë së

Këshillit të Evropës. Më tej, gjatë punimeve të Forumit, pjesëmarrësit do ta kenë mundësinë ta ndjekin panelin kushtuar transformimit të gjellbër të qyteteve në Ballkanin Perëndimor, me Erion Veliaj, kryetar i Bashkisë së Tiranës, Danela Arsovska, kryetar i Bashkisë së Shkupit, Përparim Rama, kryetar i komunës së Prishtinës, Samir Avdiq, nënkryetar i Bashkisë së Sarajevës dhe Luka Rakçeviq, nënkryetar i Bashkisë së

Podgoricës. Pjesë e programit të Forumit janë edhe prezantimet e praktikave më të mira të BE-së si dhe zgjidhjet digjitale që mund të kenë ndikim konkret drejt mjedisve urbane më të pastra dhe më inteligjente. Zgjidhjet digjitale janë nxitur në kuadër të nismës së RCC-së, Balkathon, një konkurs vjetor për zgjidhjen digjitale më të mirë rajonale, që mbahet që nga viti 2020.

"Hashim Thaçi, shqiponjë që pengon shumë koka politike", Rama: Braktisja në Hagë prej urrejtjes ndaj tij

Kryeministri Edi Rama në seancën e Kuvendit të Shqipërisë nuk ka lënë pa përmendur as ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi dhe akuzat që janë duke u barë në adresë të tij edhe pse gjendet në Hagë. Duke i dalë Thaçit në mbrojtje, Rama ka thënë se ai është "një shqiponjë që pengon shumë koka politike edhe në kafazin e Hagës". "Por, se duhet t'i përgjigjem si ka mundësi? Arsyja e braktisjes ulëritëse të atyre në Hagë nga të gjithë ata që i kanë braktisur, në fakt si të gjitha arsyet e zvarritjeve të shqiptarëve në historinë e tyre është një tjetër, sa banale aq dhe koherente, me gjithë thelbin e qorrbelasë politike që e përndjek shtetin shqiptar që nga viti 1912. E dini si e ka emrin? Urrejtje! Urrejtja për Hashim Thaçin si fitimtar i luftës që donte medoemos të fitonte dhe paqen. Po atë shprehjen të djegësh jorganin për një plesht e keni parasysh? Nuk ka kafshë më të keqe se njeriu kur humb arsyen dhe nuk ka egërsi të dytë si ajo e pleshtit të urrejtjes brenda njeriut. Hashim Thaçi natyrisht është një shqiponjë që edhe në kafazin e Hagës i pengon jo pak koka



politike apo të politizuara shqiptarësh të mendojnë të lirë se si duhet ta fitojnë luftën diplomatike me Serbinë që u mund me armë dhe zgjuarsit diplomatike prej thuajse çerek shekulli nga Hashim Thaçi me shokë. Që ngritën botën në këmbë me ato pushkët e tyre, shumëkush andej e disa këtej janë gati të dëgjin për pleshtin e urrejtjes së tyre jo thjesht jorganin e sigurisë së Kosovës bashkë me jorganin e sigurisë së Shqipërisë, por të dëgjin dhe procesin e formësimit të plotë të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës, i cili kalon vetëm e vetëm përmes shtegut të vështirë të dialogut, normalizimit dhe paqes përfundimtare me Serbinë kra

për krah me aleatët tanë, ShBA-në dhe BE-në. Asnjë shteg tjetër!", ka thënë Rama, duke shtuar se nuk ka ndër të më të madh për të sesa të jetë i bashkakuar me Thaçin në militantët në Kosovë dhe Shqipëri. "Me këto plotëformimi i subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës nuk arrihet kurrë, përkundrazi shtyhet pafundësisht. Po, të paktën, është mirë që teoricienët dhe praktikantët e patriotizmit electoral ta dëgjojnë këtu sot se për mua nuk ka nder më të madh se të jem i bashkakuar me Hashim Thaçin si tradhtar në raport me Kosovën dhe nuk ka provë më të madhe se kjo për dritëshkurtësinë dhe papërgjegjshmërinë historike të përpiluesve të saj. Ata kujtojnë se lufta diplomatike me Serbinë fitohet duke shkarravitur flamurin e UÇK-së, se lufta fitohet duke izoluar nga aleatët e mëdhenj të Kosovës pa të cilët nuk do ta kishte fituar kurrë luftën e nuk do të ishte njohur kurrë si shtet e, fatkeqësisht, kujtojnë se lufta diplomatike ndaj Kosovës fitohet duke nxitur armiqësi ndaj Qeverisë së Shqipërisë, pastaj ndaj meje personalisht", ka thënë Rama.

ka thënë Rama, duke shtuar se vrasja e Afrim Bunjakut në Banjskë, në të dyja anët e kufirit, është shfrytëzuar për ta rritur mbështetjen elektorale dhe

ushqimin e ndjenjave armiqësore ndaj tij. "Nga Prishtina në Tiranë nga profile politike e mediatiqe u nxit menjëherë pas ngjarjes së Banjskës furia kinse patriotike e

radhës ndaj meje si vëllai i Vuçitit. Ishte e dhimbshme të shikoje në të dyja anët e kufirit daljen në pah të synimit të ulët të shfrytëzimit të jetës së humbur të policit duke

Rama: Neveri të cilësohet Ramush Haradinaj tradhtar i kombit

Përpos Thaçit, kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, i ka dalë në krah edhe ish-kryeministrit Ramush Haradinaj. Rama i ka cilësuar të neveritshme sulmet ndaj Haradinajt në rrjetet sociale pas publikimit të një video ku ai shihet në takim me përfaqësuesit e Listës Serbe. "Unë Albin Kurtin e kam mik, më shumë se Haradinajn me të cilin në një segment të caktuar të këtij rrugëtimi jam gjendur në një konflikt personal kur ai ishte kryeministër. Ndërsa me Albinin nuk kam pasur kurrë asnjë problem personal, madje e kam kënaqësi të bisedoj me të, por me kryeministrin aktual kam divergjencë botëkuptimore, se si arrihet të qëllimi i përbashkët kombëtar. Gjithashtu, fakti se me Ramushin kemi pasur krisje, nuk ka si më pengon ta shpreh neverinë time më të madhe për një video

propagandistike të porositur dhe të shpërndarë përmes tastierave të luftës civile digjitale, ku Ramushi shfaqej duke trokitur gotat në një koktej me përfaqësuesit e Listës Serbe. E dini si është puna, Ramush Haradinaj, si çdo komandant tjetër që ka parë gjakun e vërtetë në fytyrën e shokëve të vranë nga plumbat e Serbisë fashiste, dhe si çdo luftëtar që ka fituar luftën me armë të vërteta, nuk ka si ta ketë problem të trokasë gotat me deputetë serbë të Kosovës në prani edhe të medieve, se mund të ishte në ambient privat dhe prapë të sulmohej me këto mjete mizerabël kineze duke u futur në rreth si tradhtar i kombit. Turpi i mbuloftë ata që sot e harrojnë se pa qindra mijëra Ramushët e UÇK-së s'do ta gëzonin lirinë e shprehjes deri në abuzim që kanë sot", ka thënë Rama.



rritur mbështetjen elektorale duke lëshuar gjuhën e mexhelesit publik e digjital që të rentabilizohet sa më shumë politikisht revolta e shqiptarëve

për vrasjen e policit me ushqimin e ndjenjave armiqësore ndaj personit tim gati si të isha bashkorganizator në këtë vrasje", ka thënë Rama.

Ahmeti: Mospëfshirja e zjarrfikësve në ngritjen e tavanit të kompensimeve, vendim skandaloz

PRISHTINË, 12 TETOR - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka thënë se vendimi i Ministrisë së Financave për punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës është skandaloz, sepse nuk janë përfshirë zjarrfikësit

në ngritjen e tavanit të kompensimeve. "Vendimi i Ministrisë së Financave për punën gjatë natës dhe jashtë orarit të punës është skandaloz. Pse duhet të ketë diskriminim dhe vendime selektive. Institucionet e Kosovës duhet t'i trajtojnë me dinjitet shpëtimtarët ashtu siç e meritojnë e jo të

konsiderohen kategori e punëtorëve që kërkojnë lëmshë nga institucionet për punën e tyre të dinjitetshme që e bëjnë. Nuk guxojmë të rrezikojmë me këtë institucion të rëndësishëm të sigurisë. As nuk duhet të detyrohen zjarrfikësit të hyjnë në grevë", ka thënë Ahmeti.




Prizreni hap thirrjen e dytë për aplikim në programin e bizneseve StartUp - Idea-to-Scale

PRIZREN, 12 TETOR - Komuna e Prizrenit ka hapur thirrjen për aplikim të inkubimit të bizneseve StartUp në Prizren, një program ndërmarrësie i njohur si "Idea-to-Scale". Përparësi në këtë thirrje do të kenë ndërmarrësit gra dhe vajza që dëshirojnë të jenë pjesë e një programi gjithëpërfshirës. Data e fundit e aplikimit për këtë program është 29 tetor 2023. "Aplikantët e zgjedhur do të kenë mundësinë unike të marrin pjesë në kampin përgatitor për tri ditë

me radhë. Mentorët ekspertë dhe profesionistë të fushës do të ofrojnë këshilla dhe udhëzime të çmuara për t'ju ndihmuar ta formoni vizionin tuaj në një koncept të realizueshëm të biznesit. Përfitimet që ju sjell ky program janë: qasje në resurse, mentorim dhe udhëzim, mbështetje në zhvillim të idesë, si dhe qasje në fonde dhe investime", thuhet në njoftimin e komunës së Prizrenit. Kriteret e kualifikimit janë: moshë

mbi 18 vjeç; të kenë një ide biznesi; individë dhe/ose ekupe të frymëzuara që janë të gatshëm të marrin pjesë në aktivitete dhe ngjarje të organizuara në kuadër të programit dhe të jenë të përkushtuar gjatë gjithë kohëzgjatjes së kësaj thirrjeje; të jenë nga komuna e Prizrenit. Përparësi do të kenë ndërmarrësit gra dhe vajza, bashkëthemeluese me një ide biznesi, produkt ose biznes në fazë të hershme.



Vendoset gurthemeli për ndërtimin e Bibliotekës së Qytetit "Latif Berisha" në Mitrovicë



MITROVICË, 12 TETOR - Në Mitrovicë u bë vënia e gurthemelit për ndërtimin e Bibliotekës së Qytetit "Latif Berisha", projekt ky shumë i mirëpritur nga qytetarët e komunës. Në ceremoninë e vënies së gurthemelit të Bibliotekës së Qytetit të pranishëm ishin kryetari i komunës Bedri Hamza, nënkryetari Arian Tahiri, kryesuesja e kuvendit Vesa Broja, drejtoresha e DKRS-së, Valdete Idrizi, drejtorë të drejtorive komunale, asamblistë, drejtorë të shkollave të qytetit, studentë dhe

nxënës. Në fjalën e tij kryetari i komunës, Bedri Hamza, ka theksuar se ndihet jashtëzakonisht i lumtur që sot së bashku po vendosin themelet e ndërtimit të një objekti i cili do të jetë një burim i madh i dijeve dhe kulturës për të gjithë qytetarët, veçanërisht për nxënësit, studentët dhe lexuesit e këtij qyteti. "Ndarja dhe financimi i projekteve në arsim dhe kulturë asnjëherë nuk llogaritet si shpenzim, përkundrazi, është investimi më i duhur për të

ardhmen. Ky objekt i ka munguar qytetit të Mitrovicës dhe nga sot do të jetë një vlerë e shtuar për qytetin dhe lexuesit mitrovicas. Urime dhe shihemi në përfundimin e objekteve të reja të rëndësishme të veçantë për qytetarin e komunës sonë", është shprehur Hamza. Ndërsa drejtoresha e DKRS-së, Valdete Idrizi, ka thënë se qytetarët e këtij qyteti, në veçanti lexuesit, kanë vuajtur gjatë për mungesë të një hapësire për një bibliotekë e cila që nga paslufta është bartur në disa vende.

Policia ndalon pesë vetura në Zveçan për kalim ilegal të kufirit dhe kontrabandë të mallrave nga Serbia

ZVEÇAN, 12 TETOR - Policia e Kosovës, në vazhden e zhvillimit të aktiviteteve me intensitet të shtuar, me qëllim të identifikimit dhe arrestimit të personave kryes të veprave penale dhe dukurive të tjera negative, si rezultat edhe i ndërveprimeve të përbashkëta të njësisve policore me ato të njësisve policore kufitare, kanë ndaluar disa automjete të ngarkuara me mall të dyshuar për kontrabandim në fshatin Kozarevë, komuna e Zveçanit. "Me datën 11.10.2023, rreth orës 22:45 në lokacionin e

lartcekur, nga njësitë kompetente policore janë ndaluar pesë automjete të dyshuara, ku nga to katër me targa të Serbisë dhe një me targa të RKS-së, që të gjitha me drejtues pesë të dyshuar meshkuj kosovarë, ku gjatë kontrollit të mjeteve janë hasur sasi e konsiderueshme e mallrave (produkte ushqimore dhe higjienike) të dyshuara si të kontrabanduara nga Serbia në Republikën e Kosovës", ka njoftuar Policia e Kosovës. Policia ka njoftuar se lidhur me

rastin është konsultuar prokurori kompetent, me urdhër të të cilit iniciohen rastet 'kalim i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare' dhe 'kontrabandim me mallra', ku të njëjtat procedohen në procedurë të rregullt, ndërsa mjetet e përfshira në rast dhe mallrat e ngarkuara sekuestrohen dhe dërgohen në terminalin doganor - Mitrovicë - për procedura të mëtejme, në koordinim me Doganën e Kosovës për trajtim sipas kompetencave.



Vazhdon ndëshkimi i bizneseve në Gjilan që nuk kanë përputhshmëri të çmimit raft-arkë

Gjilan, 12 tetor - Inspektorët e tregut nga Drejtoria e Inspektionit në Gjilan kanë

ndëshkuar biznesin i cili nuk ka përputhshmëri të çmimit raft-arkë. Drejtoresha e

Inspektionit, Entela Hyseni, ka theksuar se do të merren masa ndaj të gjithë atyre bizneseve të

cilat dëmtojnë qytetarin e komunës së Gjilanit me masa ndëshkuese.



Kurti: Ka rrezik të përsëritjes së sulmeve të dhunshme nga strukturat kriminale serbe

PRISHTINË, 12 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të enjten herët se ka rrezik në rritje të përsëritjes së sulmeve të dhunshme nga "strukturat kriminale të Serbisë në Kosovë". Duke folur gjatë një mbledhjeje të Qeverisë së Kosovës në Prishtinë, Kurti tha se qëllimi kryesor i tyre është "ta fajësojnë Policinë e Kosovës dhe ta paraqesin atë si forcë shtypëse mbi serbët e Kosovës". "Për ta arritur këtë nuk do të zgjedhin mjet", ka theksuar ai.

Paralajmërimi i Kurtit vjen rreth tri javë pasi Policia e Kosovës u sulmua nga një grup i armatosur serbësh në fshatin Banjskë, në

komunën e Zveçanit, më 24 shtator, ku mbeti i vrarë rreshteri Afrim Bunjaku. Në luftimet që pasuan pastaj në manastirin e fshatit u vranë tre sulmues serbë.

Serbia i ka hedhur poshtë akuzat e Kosovës se ajo qëndron pas sulmit të cilësuar nga autoritetet kosovare si "tentim për ta aneksuar veriun e Kosovës", megjithëse përgjegjësinë për sulmin e mori Millan Radoičiq, nënkryetari i deriatëhershëm i partisë më të madhe të serbëve të Kosovës, Lista Serbe, e cila mbështetet nga Beogradi zyrtar.

Kurti kujtoi veprimet e Serbisë pas sulmit, e cila shpalli ditë zie dhe i lartësoi si heronj tre sulmuesit serbë

që u vranë në Banjskë, si nxitje për sulme të reja të mundshme në Kosovë. "Fatkeqësisht, mbështetja që grupi terrorist ka marrë nga Serbia, në njërin anë duke i trajtuar ata si heronj dhe martirë, në anën tjetër duke i intensifikuar aktivitetet e ushtrisë përgjatë kufirit me republikën tonë, vetëm sa i ka inkurajuar", shtoi ai.

Ai u bëri thirrje serbëve të Kosovës në veçanti "që ditëve, javëve dhe muajve në vijim, të jeni të vëmendshëm dhe të vetëpërbajtur nga cjtjet e aktet e dhunës të inskenuara dhe dashakeqe". "Në Kosovë të gjithë jemi qytetarë të barabartë sepse shteti është ligjor dhe shoqëria është



demokratike. Nuk ka komunitete të padëshiruara. Ju ftoj të mbështeteni në Policinë e Kosovës dhe t'i raportoni sjelljet e dyshimta të

individëve nëpër komunitetet tuaja", nënvizoi Kurti. Sulmi në Banjskë është dënuar nga Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian (BE).

"Pesëshja e madhe" në Kosovë dhe Serbi në përpjekje "për ta shpëtuar dialogun"

PRISHTINË, 12 TETOR - Qëllimi i vizitës në Kosovë dhe Serbi i përfaqësuesve të pesë shteteve kryesore, sipas diplomatëve në Bruksel, është përpjekja që "të shpëtohet procesi i dialogut" dhe marrëveshja drejt normalizimit, e arritur më herët gjatë këtij viti.

Më 21 tetor përfaqësuesit e Shteteve të Bashkuara, Gjermanisë, Italisë, Francës, do ta shoqërojnë përfaqësuesin e Bashkimit Evropian për dialogun, Miroslav Lajčak, në takimet në Kosovë dhe Serbi. Sipas burimeve diplomatike në Bruksel, qëllimi i vizitës është të shtyhet përpara zbatimi i Marrëveshjes drejt normalizimit dhe Aneksit për zbatimin e saj.

Pas raundit të fundit të dialogut në nivel të lartë më 14 shtator, përfaqësuesi i lartë i bllokut, Josep Borrell, ka thënë se të dyja palët po shkelin obligimet e kësaj marrëveshjeje. Por, gjatë këtij takimi Borrelli tha se kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, nuk pranoi një plan të sekuencimit për zbatimin e



kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje, prej 11 nenesh, mes të tjerash, parasheh edhe një nivel të vetëmenaxhimit për komunitetin serb në Kosovë dhe njohje të ndërsjellë të simboleve shtetërore, ndërsa kërkon nga Prishtina dhe Beogradi t'i zbatojnë, po ashtu, të gjitha marrëveshjet e mëhershme të dialogut. "Të

gjitha këto vende janë një lloj garantuesish të marrëveshjes dhe askush nuk dëshiron të shohë atë duke dështuar. E vetmja mënyrë që situata të stabilizohet në afat të gjatë është përpjekja në procesin e dialogut dhe normalizimit", tha një burim në Bruksel. Burimet në Bruksel thanë se "është i domosdoshëm angazhimi i vendeve të mëdha

të BE-së krahas Shteteve të Bashkuara të Amerikës për ta shpëtuar dialogun pasi fuqia e përfaqësuesve të BE-së në këtë drejtim nuk do të ishte e mjaftueshme".

Vizita në Kosovë dhe Serbi e grupit që njihet si "Pesëshja e madhe" është e para që nga sulmi i 24 shtatorit kundër Policisë së Kosovës në Banjskë të Zveçanit.

Një grup serbësh të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës, duke lënë të vrarë rreshterin Afrim Bunjaku. Gjatë përlëshjeve, autoritetet thanë se u vranë edhe tre sulmues.

Kosova e ka fajësuar Serbinë për sulmin, por Beogradi ka thënë se nuk ka gisht në të. Përgjegjësinë për organizimin e sulmit e mori Radoičiqi, i cili dha dorëheqje nga pozita e nënkryetarit të Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që ka mbështetjen e Beogradit zyrtar.

ShBA-ja dhe BE-ja kanë dënuar ashpër sulmin. Borrelli e ka cilësuar sulmin terrorist. Tashmë BE-ja dhe shtetet anëtare po presin rezultatet e hetimeve për të parë se kush e kishte planifikuar sulmin, kush i kishte ndihmuar sulmuesit dhe më pas do të vendosin për masa eventuale. Tash për tash masa ndëshkuese ka ndaj Kosovës për shkak të tensioneve të mëhershme në veri të Kosovës, por në BE nuk e kanë përjashtuar mundësinë të vendosjen sanksione ndaj Serbisë.

Ambasadori amerikan në Beograd: Serbia dhe Kosova duhet të arrijnë një zgjidhje politike

PRISHTINË, 12 TETOR - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Serbi, Christopher Hill, deklaroi më 12 tetor se Serbia dhe Kosova përfundimisht do të duhet të arrijnë një zgjidhje politike për këdo që konfirmohet të jetë përgjegjës për ngjarjet në Banjskë në veri të Kosovës. "Tani ne kemi një problem që duhet zgjidhur. Kushdo që është përgjegjës për të, ne do të duhet të kemi

një zgjidhje politike, do të duhet të ulemi dhe të kuptojmë se çfarë është e drejtë", tha Hill, duke folur në Konferencën e Sigurisë të Beogradit (BSC).

Ai tha se kjo zgjidhje nënkupton "një lloj statusi" për serbët në Kosovë, në anën tjetër "ndërkombëtarizim më të madh" për Kosovën.

Hill tha se ai "do të donte që Serbia të kuptojë dhe të njohë se Kosova është një shtet i

pavarur", por problemi është "më kompleks se kaq". "Ne duhet t'i inkurajojmë të dyja palët ta dëgjojnë njëra-tjetrën", tha Hilli.

Ai shtoi se hapi i parë për zgjidhjen e krizës aktuale është të kuptohet se çfarë ndodhi. "Së pari, duhet të kuptojmë se çfarë ndodhi dhe t'i mbajmë përgjegjësit përgjegjës, pastaj të sigurohemi që diçka e tillë të mos ndodhë më", tha Hilli.



Guvernatori Ismaili zhvillon takime me zyrtarë të lartë të FMN-së, të BB-së dhe të IFC-së

Prishtinë, 12 tetor - Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, gjatë qëndrimit të tij në Marakesh, po vazhdon të zhvillojë takime me zyrtarë të lartë të Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Bankës Botërore (BB) dhe Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC).

Në ditën e tretë të takimeve vjetore të FMN-së dhe BB-së, guvernatori Ismaili ka bashkëbiseduar me zëvendës drejtorin e Departamentit të Tregjeve

Monetare dhe të Kapitalit në FMN, Miguel Savastano, me zëvendës presidentin e IFC-së për Evropë, Alfonso Garcia Mora, drejtoreshën rajonale të IFC-së, Rana Karadsheh dhe drejtorin ekzekutiv të Konstituencës në FMN, Daniel Palotai.

Gjatë takimeve të ndara janë paraqitur aspektet kryesore të bashkëpunimit dhe prioritetet zhvillimore ndërmjet BQK-së dhe këtyre institucioneve financiare ndërkombëtare. Po ashtu, guvernatori Ismaili është

zotuar për një dialog konstruktiv dhe se është premtuar përkrahja dhe avancimi i mëtejshëm i marrëdhënieve institucionale. Guvernatori Ismaili gjatë ditëve në vijim do të ketë takime edhe me guvernatorë të bankave qendrore dhe institucione të tjera financiare pjesëmarrëse, krahas nënshkrimit të marrëveshjes për anëtarësim në Programin "Reserve Advisory & Management Partnership" (RAMP), të Thesarit të Bankës Botërore.



Rizvanolli: Serbia po e bojkoton udhërrëfyesin për energjinë



**EPOKA
ERE**

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 TETOR - Ministri e Ekonomisë e Kosovës, Artane Rizvanolli, e ka akuzuar të enjten Serbinë se nuk po e zbaton udhërrëfyesin për marrëveshjen për energjinë në katër komunat në veri të Kosovës. "Ne kemi bërë të qartë për të gjitha palët se, një

mënyrë e tillë e funksionimit nuk mund të funksionojë. Institucionet tona kanë kryer detyrat në afatet e duhura të marrëveshjes, kurse nga pala tjetër ka sabotim", tha Rizvanolli.

Kosova dhe Serbia kishin arritur marrëveshje për energjinë më 2013, por ajo kurrë nuk ishte zbatuar në tërësi. Në qershor 2022 palët u pajtuan në Bruksel për

udhërrëfyesin për zbatimin e marrëveshjes për energjinë. Në bazë të udhërrëfyesit, kompania për furnizim dhe faturim të veriut me rrymë do të merret kompania serbe "Elektrosever", por BE-ja kishte konfirmuar vitin e kaluar se ka vonesa në zbatimin e udhërrëfyesit.

Qytetarët e komunave në veri të Kosovës, Mitrovicë e Veriut,

Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok, kryesisht me shumicë serbe, nuk kanë paguar për rrymën e shpenzuar që nga viti 1999.

Përgjatë viteve borxhi i tyre është paguar nga qytetarët e komunave të tjera të Kosovës dhe që nga viti 2017 nga Qeveria e Kosovës.

Por, Rizvanolli theksoi se Qeveria e Kosovës nuk ka ndarë ndonjë shumë të mjeteve financiare për

pagesën e faturave të energjisë elektrike për banorët e katër komunave në veri të Kosovës. "Kemi pasur kërkesa të vazhdueshme nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut i Kosovës (KOSTT) që nga ajo kohë, mirëpo nuk kemi ndarë mjete shtesë si qeveri", tha Rizvanolli në mbledhjen e qeverisë mbajtur të enjten.

Aprovohet kërkesa e Telekomit për huamarrjen e 15 milionë eurove

PRISHTINË, 12 TETOR - Qeveria e Kosovës ka aprovuar kërkesën e Telekomit për huamarrjen e 15 milionë eurove për projekte investive në këtë ndërmarrje.

Vendimi është marrë në mbledhjen e së enjtes, ndërsa kryeministri Albin Kurti tha se fuqizimi i ndërmarrjeve publike dhe rikthimi i tyre drejt profitabilitetit përmes

mirëmenaxhimit dhe investimeve kapitale është prioritet i qeverisë.

Ndërsa ministri i Financave, Hekuran Murati, tha se ministria ka shqyrtuar kërkesën e Telekomit e cila fillimisht ka qenë 20 milionë euro. Por, sipas tij, meqenëse vitin e kaluar kanë aprovuar pjesën e parë prej 5 milionë eurosh për t'i filluar investimet, tani është radha

që të vihet në dispozicion edhe pjesa e dytë prej 15 milionë eurove dhe të kompletohet i tërë plani investiv.

"Kjo kredi do të shërbejë për investime në pajisje dhe sisteme telekomunikuese si dhe në përmirësimin e shërbimeve të Telekomit", ka thënë ai duke shtuar se Telekomit ka pasur nevojë për këtë kredi shtesë.



Shqipëria tregoi kurriz shtetëror në rastin Goxhaj dhe Beleri



Behxhet SH. SHALA - BAJGORA

Shtylla kurrizore si ndërtim anatomik për përfitim politik: Kohën e fundit shteti shqiptar u sfidua në dy raste ku, ose do të dilte me kurriz të drejtë, ose e pafytyrë, e nënshtruar dhe e turpëruar. Në rastin e parë bëhet fjalë për Fredi Belerin i cili u zgjodh kryebashkiak i Himarës vetëm pasi e arrestuan për blerje dhe manipulim me vota. Po të mos arrestohej para zgjedhjeve puna e tij do të kishte përfunduar dhe askush nuk do të merrej me të përveç organeve të drejtësisë. Kështu, pas arrestimit u shndërrua në "martir" në saje të së kaluarës problematike politike, kombëtare dhe për këtë neoandartët grekë, bashkë me disa politikanë shqiptarë të korruptuar materialisht, kombëtarisht, politikisht dhe moralisht, këtë çështje e ngritën duke i dhënë përmasa ndërkombëtare. Në veçanti politikanët nga Greqia hynin e dilnin në Shqipëri sikur të ishte oborri i Vanizelosit duke bërë presion në të gjitha nivelet e pushtetit, nga ai lokal e deri te kryeministri Rama. Ishte ndërhyrje e paskrupullt në pavarësinë e organeve të drejtësisë duke e kërcënuar Shqipërinë me masa ekonomike, politike dhe bllokim

në rrugën e integritit evropian. Deri më tani Shqipëria qëndroi drejt dhe nuk iu nënshtrua asnjë shantazhi duke e konsideruar me të drejtë "rastin Beleri" si çështje e drejtësisë e jo çështje politike. Kryeministri karizmatik i Shqipërisë, Edvin Rama që ia ndryshoi për të mirë fytyrën e Tiranës, sa ishte kryetar Bashkie e pastaj edhe Shqipërisë, si kryeminister iu nënshtrua një presioni të paskrupullt nga Greqia dhe një pjese të palegalizuar të opozitës në Shqipëri por se deri më tani mbeti në kuadër të përgjegjësive me të cilat e ka ngarkuar Kushtetuta e Shqipërisë duke mos u lëkundur në qëndrimet parimore. Greqia lobi edhe te shtetet tjera për rastin Beleri në mënyrë që të kontrabandohet betimi i tij si kryetar i bashkësisë së Himarës pa u pastruar para ligjit për vepër që drejtpërdrejtë ndikoi në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve. Rasti i dytë ishte ai i Dritan Goxhaj, shqiptar dhe shtetas i Shqipërisë që mori pjesë në luftën e së Lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës në krye komandantin politik Bacë Adem Demaçi dhe komandantin ushtarak, Legjendarin Adem Jashari. Dritan Goxhaj që e kreu me nder detyrimin ndaj Kombit

dhe Atdheut në luftën e fundit, me urdhëresë të një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale juridike me emrin Gjykatë Speciale u arrestua në Tiranë, me kërkesë që të ekstradohet në Qendrën e Paraburgimit në Hagë ku po mbahen si pengje udhëheqësit më të lartë ushtarakë dhe politikë të Kosovës që e udhëhoqën luftën çlirimtare, e ndërtuan paqen në Kosovës sikur që ishin më meritoret për shpalljen e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008 e që fuqishëm kundërshtoheshin nga Serbia dhe një pjesë e institucioneve që aktualisht e udhëheqin Kosovën. Luftëtari i lirisë, Dritan Goxhaj në një shkrim autorial për luftën dhe proceset e tanishme pati një qëndrim, për Gjykatën Speciale dhe përkrahësit e saj mund të cilësohet edhe si kritikë por, nga një vështrim neutral ishte shkrim real dhe me asgjë inkriminues. Nëse Gjykata Speciale nuk lë mënyrë pa keqpërdorur për të rënduar të burgosurit me prova të Beogradit dhe disa bashkëpunëtorëve të tyre të strehuar dhe sistemuar shumë mirë në institucionet më të larta të Kosovës, pse atëherë ish bashkëluftëtarët e pengjeve që

po mbahen në Hagë të mos kenë të drejtë të angazhohen për mbrojtje të tyre dhe me solidarizim ndaj tyre?! Pse paska të drejtë një horr apo horrake që e mbanë një post të pamerituar në ministri të caktuara dhe se avansohet nëse dëshmon kundër pengjeve të Hagës ndërsa, në anën tjetër çdo përpjekje të bashkëluftëtarëve por edhe të atyre që nuk pajtohen me këtë gjykatë, përndiqen si pengues të drejtësisë, frikësim të dëshmitarëve apo pengim të personave zyrtarë. Pastaj dalin e thonë se po iu rrezikohet jeta shkaku i dëshmitëve të tyre ndonëse me dëshmitë e tyre, kryesisht të rreme dhe të motivuara nga urrejtja ndaj luftës dhe politikisht, rrezikojnë dhjetëra e qindra jetë të tjerëve. Hetuesit e Gjykatës Kriminale Speciale më lirshën hyjnë në çdo familje shqiptare në Kosovë se në ndonjë kafiteri në vendin nga e kanë origjinën. Kur të duan të marrin në biseda informative, ju arrestojnë dhe dënojnë shqiptarë (por jo edhe serbë që kanë kryer krime deri në përmasa të gjenocidit), pa asnjë kundërshtim, thuaja në kushte të nënshtrimit të padinjitetshëm. Ekstradohen po të njëjtën ditë, pa iu nënshtruar

procedurave ligjore duke u thirrur se është themeluar nga Kuvendi i Kosovës dhe se është pjesë e sistemit të drejtësisë së Kosovës ndonëse asnjëherë dhe për asgjë nuk i raporton, as themeluesit e as sistemit të drejtësisë. I ka shtrirë për toke duke i zhveshur nga çdo përgjegjësi dhe mandat, duke ua mohuar edhe atë pjesë të vogël të fytyrës dhe nderit, moral dhe profesional. Po të njëjtën recetë janë munduar të zbatojnë edhe në Shqipëri sikur edhe në shtetet tjera ku jetojnë shqiptarët e që janë, jo subjekt por thjesht objekt i keqtrajtimit nga kjo gjykatë. Drejtësia shqiptare por edhe udhëheqja politike qëndruan vertikalisht, si në rastin Beleri ashtu edhe në rastin Goxhaj duke mos iu nënshtruar shantazheve, në njërin anë por edhe duke mos ndërhyrë politikisht në vendimmarrjen e organeve të drejtësisë. Po të ishte Dritan Goxhaj "shtetas" i Kosovës dhe po të varej nga drejtësia kosovare dhe një pjesë e udhëheqjes politike, jo që nuk do të ishte liruar por që nga dita e parë do të pëshurte në nevojtoret e Qendrës së Paraburgimit në Hagë, në emër të bashkëpunimit ndërkombëtar, si maskë dhe në emër të urrejtje ndaj luftëtarëve



të UÇK-së e që është realitet! Dritan Goxhaj e ruajti fytyrën dhe kurrizin si në kohë lufte ashtu edhe në kohë paqeje; fillimisht luftoi për të drejtën për liri të popullit që i takon dhe së fundmi luftoi për të mbrojtur të drejtën për të vërtetën, që gjithashtu i takon dhe e detyron lufta që e bëri në Kosovë. Nuk e njoh Dritan Goxhaj por i përkulem me nderimin më të lartë për luftën që e bëri gjatë luftës dhe “luftën” që e bëri gjatë paqes!

Kur zuzarët dhe dezertorët flasin për luftën: Pas rastit të sulmit terrorist nga Manastiri në fshatin Banjskë ku Radoiqi, Vulini dhe Vuçiqi u peshkuan lehtësisht nga shërbimet e huaja, edhe Ukraina që ishte epiqendër e angazhimit politik dhe ushtarak i Vojsa Osmanit, Albin Kurtit dhe Glauk bin Sherifit ra nga interesimi i përqendruar i “komandantëve institucionalë” të Kosovës. Tash, retorika ushtarake dhe luftarake u zhvendosë në Banjskë ku dolën fakte dhe plane të padëguara dhe të papara që e rrezikonin Kosovën dhe vetën falë syçeltësisë dhe sakrificës së “komandantëve institucionalë”, Kosova shpëtoi, së paku përkohësisht. Pasi Banjska u mbyllë falë shërbimeve të huaja, angazhimit shumë profesional të Policisë së Kosovës, shumica ish ushtarë të UÇK-së ose vazhdues të traditave familjare në luftë kundër pushtimit si dhe

policë të shkolluar dhe aftësuar gjatë periudhës 20-vjeçare që udhëhiqej nga “shkatërruesit e shtetit”, tash po flitet për vatra tjera të krizës. Thjesht, duke ushqyer opinionin me rrezik për luftë, po e zhvendosin vëmendjen nga një situatë e rëndë, humbje e perspektivës, korrupsionit, nepotizmit idiotesk (nuk punësohen familjarët e aftë por ata që me asgjë nuk e meritojnë), mungesë të investimeve kapitale, papunësinë e madhe dhe rrezikun që pas janarit struktura e të punësuarve të ndryshojë rrënjësisht ku do të mbesnin vetëm përkrahësit e qeverisë dhe ardhacakët nga Azia dhe Afrika. Këta që po flasin për luftë e kanë prapancën e madhe, luftën e mbajnë mend vetëm duke e kundërshtuar apo duke dezertuar nga ajo. Të tillët nuk bëjnë luftë por i shtyejnë tjerët në luftë...pastaj i dekorojnë apo ua lënë një grusht euro te shtëpia. Të mjerë dhe të poshtë janë! Në Kosovë nuk ka luftë dhe nuk do të ketë luftë me Serbinë. Mund të ketë luftë qytetare, luftë vëllavrasëse, asgjë tjetër. Serbia nuk e do luftën, pushteti edhe më pak ose aspak. Vetëm janë duke e helmuar mjedisin jetësor. A do ta bëjnë luftën bijtë dhe bijat e atyre që pas luftës, si kriminelë të OZNA-së rrihnin, arrestonin dhe vrisnin patriotë shqiptarë. Këta sot mbajnë poste të larta institucionale. Sidomos udbashët nga Drenica, Dukagjini, Anamorava sot kanë

poste institucionale dhe kanë mundësi të vazhdojnë traditën familjare duke përndjekur patriotët shqiptarë, ushtarët e UÇK-së dhe të burgosurit politikë! Ka horra dhe horrake që kanë fituar poste në saje të sakrificave të paraardhësve të tyre dhe, që turpi të jetë edhe më i madh, e mbajnë mbiemrin e tyre! Shihni sot si jetojnë (në fakt bëjnë përpjekje për mbijetesë) pensionistët, përfituesit e skemave sociale, ushtarët e UÇK-së dhe invalidët e luftës, të burgosurit politikë dhe do ta keni të qartë pse manipulohet me luftën nga qyqarët dhe zuzarët e dëshmuar. Të poshtër!

Gjuha e urrejtjes dhe racizmi: Sot, sidomos politikanët e pozitës dhe përkrahësit e tyre mediatik, me të madhe e përdorin gjuhën e urrejtjes ndaj kryeministrit Edi Rama sikur që e përdorin edhe gjuhën e urrejtjes të mbështjellur me një racizëm të poshtër ndaj Drenicës, UÇK-së, të burgosurve politikë dhe pengjeve shqiptare që po mbahen në Burgun e Hagës. Edi Rama kritikohet, shahet, urrehet nga, siç thotë Umberto Eko, idiotët e rrjeteve sociale që mendojnë se tërë bota merret me postimet e tyre. Këta që po e kritikojnë Edi Ramën që ka kërkuar që KFOR-i ta marrë kontrollin e veriut të Kosovës nuk po e përmendin faktin se KFOR-i e ka shtuar për disa qindra ushtarë praninë në veri dhe se nuk ka shtet që nuk ka dërguar

forca shtesë. Gjithashtu e mëshehin faktin se pa lejen e KFOR-it as Policia e Kosovës nuk do të shkonte në veri e as Xhelali nuk do të raportonte aq lirshëm, si zëdhënës i Policisë, nga veriu. Edi Rama është kryeministër i Shqipërisë dhe për çdo angazhim në dobi të Kosovës është fajësuar se po mban qëndrim paternalist për Kosovën. Pse duhet të flasë Edi Rama për veriun kur atje e kemi një ministër si Faraoni Krasniqi, një sakrifikes si Lulëzim Hetemi, i njohur si Lulo Kuka nga Leposaviqi etj. Raporti Kurti - Rama nuk është i natyrës politike e lëre më kombëtare, është raport i kompleksit të inferioritetit. Është raport që i takon domenit të psikologjisë dhe psikiatrisë! Për çdo njeri normal dhe lirisht, Drenica është Vendlindja e Lirisë dhe Pavarësisë kurse Prekazi është kryeqytet i kësaj Lirie dhe Pavarësie. Për ata që personalisht dhe familjarisht kanë qenë kundër lirisë dhe pavarësisë, Drenica është realitet i shpërftyfrimit të tyre njerëzor, moral, kombëtar dhe politik, pra është vend primitiv që nuk socializohet kurrë, që vijnë në Prishtinë për t'u ngrohur (çfarë idioti), që kanë vozitur bilispica, që janë rritur me buallica dhe që janë shpërdorues të lirisë pasi kanë qenë kundër kriminelëve jugosllavë dhe serbë apo kotillës së tyre kombëtare dhe politike ku bëjnë pjesë Hakaka Nukaka, me pordhët nga bregdeti dhe ky farë

leshkuraci i Kuvendit. Drenicën më së shumti e kanë sulmuar dhe dëmtuar ata që flisnin shqip por që mendonin dhe vepronin serbisht. Shaban Polluzhën dhe Mehmet Gradicën më shumë e kanë luftuar Fadil Hoxha nga Kosmeti dhe Shefqet Peçi nga Shqipëria se partizanët e Rankoviqit, Dapçeviqit dhe Titos. Hakaka Nukaka, si këshilltari kryesor i Kurtit e ka instaluar dhe promovuar institucionalisht gjuhën e urrejtjes dhe racizmin kundër Drenicës prandaj pse ia shihni për të madhe dikujt tjetër që, për shkak të papërgjegjshmërisë dhe injorancës që e ka, në një shtet normal vetëm nën kujdestari do të futej në Kuvend e që e thotë këtë që e thotë. Çfarë poshtërsie!

Megjithatë ka të arritura edhe në diplomaci: Ministria që udhëhiqet nga Zonja Katran (Shavrc) është shndërruar në një qendër të prostituiimit diplomatik. Gjatë këtij mandat asnjë njohje për Kosovën përveç paraqitjeve skandaloze të vetëlavdërimit, spastrimit të ministrisë nga njerëz të papërshtatshëm për regjimin, nepotizmin partiak dhe familjar dhe shumë margaritarë, të padenjë edhe për korin diplomatik të fisit Zulu, më në fund u shënuar një arritje e madhe; ambasadori i Kosovës në Bangladesh u bë anëtar i jurisë për zgjedhje të mis Turizmit në Bangladesh. URIME DHE LAVDI MARRËZISË!

Fjala e Frashërit në Lidhjen e Kombeve



Dy ligjërime të Mid'hat Frasherit mbajtur në Lidhjen e Kombeve në vitin 1923, janë botuar në librin e studiuesit Aurenc Bebja që sapo ka dalë në qarkullim.

Zoti President: Fjalën e ka z. Frashëri, Delegat i Parë i Shqipërisë. Z. Midhat Frashëri (Shqipëri):

– Zoti President, zonja dhe zotërinj, po ngitem në foltore për të përbushur një detyrë. Unë vij t'i jap llogari Shoqërisë së Madhe për mirënjohjen e vendit të vogël që kam nderin ta përfaqësoj dhe që në fakt e konsideroj të kushtëzuar me Lidhjen e Kombeve nëpërmjet lidhjeve të njohjes.

Shqipëria, zotërinj, mund të quhet ndrikull e Lidhjes së Kombeve. Ishte Lidhja e Kombeve që e ndihmoi në rilindjen e saj, e pranoi në mesin e saj dhe i mundësoi të vendoste marrëdhënie diplomatike me shtetet e tjera. Rruga që i kishte hapur Lidhja e Kombeve ishte më e lehtë më vonë, pasi ky kumbar, ose më mirë kjo kumbarë, nuk pushoi së interesuari për shtetin e vogël.

Që atëherë – mund ta pohoj këtë pa frikë që të përgënjeshetrohet – Shqipëria ka bërë çdo përpjekje për të merituar përkushtimin e Lidhjes së Kombeve. Gjendja e brendshme e saj është përmirësuar gjithnjë e më shumë, marrëdhëniet me fqinjët kanë hyrë në një fazë normale; marrëdhëniet diplomatike janë vendosur dhe rruga që ajo duhet të kalojë, i është lehtësuar kështu.

Edhe pse një nga kombet më të rinj që ka hyrë në Lidhjen e Kombeve, Shqipëria është një nga vendet më demokratike për nga kushtetuta dhe administrata e saj. Këtu mund të dëshmoj se idetë e përfaqësuar nga Lidhja e Kombeve gjejnë te shqiptarët partizanët më të bindur.

Nuk janë vetëm parimet, por është pikërisht ideali që përfaqëson kjo Shoqëri, është kjo vëllazëri, ky solidaritet midis popujve që ne vijmë të konfirmojmë çdo vit këtu përsëri, të cilët gjejnë ndër shqiptarët më të bindurit.

Unë i përkas një rajoni të Evropës që ka vuajtur shumë, ndoshta ai që ka vuajtur më shumë gjatë dy dekadave të fundit.

Është ky rajon i Evropës që kishte më shumë nevojë për paqë, pajtim dhe harmoni midis elementëve të ndryshëm të tij. Popujt ballkanikë kanë filluar të kuptojnë se ka vetëm një mënyrë për të arritur prosperitetin, vetëm një mënyrë për të shpëputur zakonet e këqija të së kaluarës, sipas të cilave çdo popull përtej kufirit konsiderohej armik. Ata tashmë e kuptojnë se një solidaritet interesash të përbashkëta, materiale dhe ekonomike, madje edhe morale e intelektuale, duhet t'i bashkojë popujt dhe jo t'i ndajë ata.

Kjo ide e popujve ballkanikë mbështetet fuqishëm nga ndikimi i qeverive të tyre përkatëse. Besoj se jam interpretuesi besnik i kësaj ndjenje kur them se perspektiva e një lufte, natyrisht mjaft të largët, tmerron popujt e Ballkanit, që aspirojnë paqen. Megjithatë, të gjitha përpjekjet e tyre nuk mundën të çonin në një rezultat të shpejtë dhe të menjëhershëm.

Ata përhapin një energji të madhe për këtë qëllim dhe atmosfera e Gjenevës, jo vetëm e këtij qyteti ku njerëzit vijnë për të shijuar lirinë fetare dhe politike, por edhe atmosferën e kësaj Shoqërie të Madhe ku ne vijmë çdo vit për të rizhytur veten në idetë e vëllazërisë, bashkëpunimit dhe solidaritetit, kontribuon shumë në këtë. Kjo atmosferë e dobishme kontribuon në masë të madhe në përmirësimin e marrëdhënieve që theksohen dita-ditës. Mirëpo, a

mjafton të kufizohemi vetëm në ardhjen këtu për t'u mbushur me frymë në atmosferën e Lidhjes së Kombeve, apo nuk është ende e nevojshme të mbështesim përpjekjet e lindura nga nevojat imperative të vendeve të Ballkanit? Dje, delegati i shquar i Greqisë foli për punën e mirë të një delegati të Lidhjes së Kombeve, i cili aktualisht kryeson zgjidhjen e vështirësive të vogla, të cilat, për fat të keq, ende ekzistojnë midis disa elementeve ballkanike.

Ky është një shembull i mirë që ilustron qartë punën e dobishme që Lidhja e Kombeve po kryen dhe do të vazhdojë të kryejë në të ardhmen. Ndërhyrja e drejtpërdrejtë e një delegati të caktuar nga Lidhja e Kombeve mund të arrijë më shumë në dy javë sesa tre vjet përpjekje të vetë popujve. Nëse shtetet ballkanike do t'i drejtoheshin Lidhjes së Kombeve, përfaqësuesit e së cilës shfaqin një frymë të madhe pavarësie dhe paanshmërie, çdo herë që do të lindte një vështirësi e vogël, për të kërkuar mbështetjen morale dhe ofiqet e mira mjaft të paanshme, ato do t'i bënin një shërbim çështjes së paqes.

Sigurisht, zona e rajonit të Ballkanit nuk është shumë e madhe, por idetë që mbretërojnë brenda Lidhjes së Kombeve janë të frymëzuara nga solidariteti i ngushtë që ekziston midis të gjitha vendeve, midis të gjitha rajoneve, të mëdha e të vogla. Kështu, të gjitha shtetet formojnë një tërësi, një trup harmonik. Sëmundja më e vogël, lëndimi më i padukshëm mund të prekë të gjithë trupin; po kështu vështirësitë e vogla, mosmarrëveshjet e vogla ndërmjet elementëve përbërës të një vendi apo rajoni mund të prekin të gjithë kombet e tjerë.

Nëse hyj në këto konsiderata, është sepse duhet t'i jap llogari Lidhjes së

Kombeve, si një shoqëri aksionerësh. Lidhja e Kombeve na ka investuar me kapital moral të destinuar të japë fryte. Ky kapital moral, në fakt, shpërblehet çdo vit e më shumë.

Progresi i arritur në një vend të vogël vetëm sa mund të rrisë numrin e mbështetësve të Shoqërisë sonë të Madhe dhe të konsolidojë besimin që duhet të kemi në të ardhmen e saj dhe në shërbimet që ajo është thirrur të bëjë.

Të nderuar delegatë, Lidhja e Kombeve nuk lindi vetëm nga vullneti i pak njerëzve; nuk lindi vetëm nga një pakt; përfaqëson, në sytë e popujve të vegjël që kanë filluar të ndërgjegjësohen për të drejtat e tyre, manifestimin e një ideali të ri, atë të vëllazërisë dhe mbi të gjitha të solidaritetit midis vendeve të ndryshme.

(Duartrokitje.)

Minoritetet në Shqipëri. Société des Nations – Journal Officiel, nëntor 1923, faqe 1312:

Z. Midhat Frashëri, përfaqësues i Shqipërisë, zuri vend në tryezën e Këshillit.

Z. De Rio Branco, raportues, lexoi raportin e tij (Shtojca 564).

Z. Midhat Frashëri deklaroi: Shqipëria është pajtuar me klauzolat që kanë të bëjnë me minoritetet, me vullnetin e vetëdijshëm për të përbushur me përpikëri angazhimet e saj, për t'i respektuar ato me sigurinë e kryerjes së një detyre njerëzore dhe të ndershme.

Vendi që kam nderin të përfaqësoj u ka dhënë pakicave etnike që jetojnë brenda kufijve të tij të gjitha të drejtat fetare, kulturore, civile dhe qytetare. Në këtë aspekt, Shqipëria është shteti më liberal në pjesën

juglindore të Evropës. Për të arritur këtë rezultat, asaj nuk iu desh t'i impononte vetes sakrifica morale, liria dhe barazia që u jepte pakicave nuk kërkonin asnjë përpjekje nga ana e saj; por, për të kënaqur të ardhurit, i ka imponuar vetes sakrifica materiale shumë të rënda. Megjithatë, Shqipëria është e gatshme të ndjekë të gjitha sugjerimet dhe rekomandimet që vijnë nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve, e bindur se Këshilli, në parimet e barazisë që e dallojnë, ka vetëm një peshë për drejtësinë dhe se përkujdesja e treguar prej tij ndaj pakicave në Shqipëri do të shtrihet edhe në minoritetet shqiptare që jetojnë në shtetet fqinje dhe që pretendojnë gjithashtu mbrojtjen e Lidhjes së Kombeve.

Këshilli miraton rezolutën e mëposhtme:



Këshilli mban shënim informacionet e dhëna deri më sot nga qeveria shqiptare, në zbatim të nenit 5, paragrafi 2, të deklarimit shqiptar të 2 tetorit 1921, lidhur me mbrojtjen e minoriteteve dhe falenderon qeverinë shqiptare për transmetimin e këtyre të dhënave.

Sekretari i Përgjithshëm udhëzohet të studiojë informacionin e përmendur, në bashkëpunim me përfaqësuesin shqiptar, dhe t'i paraqesë konkluzionet e tij Raportuesit, i cili në kohën e duhur do t'i paraqesë një raport Këshillit.

Z. Midhat Frashëri:

Duke qenë se përfaqësoj jo vetëm shumicën, por edhe pakicat në Shqipëri, dua të falënderoj Këshillin, i cili me votën që sapo ka dhënë, dëshmon interesin që ka për situatën e këtyre pakicave në Shqipëri. Falënderoj gjithashtu Sekretariatit e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve dhe të nderuarin raportues.

Z. Midhat Frashëri largohet.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Fitore e madhe e Shqipërisë ndaj Çekisë – kuqezinjtë me një këmbë në EURO 2024

SHQIPËRI, 12 TETOR - Shqipëria ka shënuar fitore ndaj Çekisë me rezultat 3-0 në ndeshjen eliminatorë për Euro 2024.

Çekët e kishin nisur më mirë ndeshjen duke rrezikuar që në start me Mojmir Chytil që gjuajti nga distanca, por Etrit Berisha ishte në vend.

Shqipëria u lirua në lojë dhe arriti ta zhblllokojë ndeshjen në minutën e nëntë, kur Jasir Asani si zakonisht nga distanca shënoi super gol për 1-0.

Festë e madhe në Air Albania nga 22 mijë tifozë që janë tubuar në stadium.

Në minutën e 18-të, Shqipëria ka mundur të shtojë epërsinë kur Jiri Pavlenka bëri pritje shumë të mirë në goditjen e Sokol Cikalleshit.

Në minutën e 40-të u duk që Çekia barazoi shifrat, kur Mojmir Chytil shënoi. Por gjyqtari e kishte vrenjtur që ai e kishte shtyrë topin me dorë në rrjetë dhe e ndëshkoi me karton të verdhë që ishte i dyti për të, duke e lëshuar lojën.

Shqipëria ka mundur të shënojë edhe në fundin e pjesës së parë, kur Ylber Ramdani mori një top në mesfushë dhe nisën bukur një kundërsulm, por pasimi për Nedim Bajramin ishte i shpejtë.

Me të filluar pjesa e dytë, Shqipëria hipotekoi fitoren, duke shënuar golin e dytë.

Zhvillohej minuta e 51-të, kur Asani harkoi për tokë një top në zonë, që u ulë nga Sokol Cikalleshi bukur për të shkuar te Taulant Seferi i cili shënoi me një gjuajtje të fortë për 2-0.

Por djelmoshat e Sylvinhos nuk u ndalën dhe shtuan epërsinë në minutën e 73-të për 3-0, ku Mirlind Daku asiston te Taulant Seferi i cili me portën e zbrazët shënoi golin e dytë personal.

Në minutën e 82-të ishte radha e Arbnor Mujës që të shënojë, por pasi rasti u shikua në VAR u



anulua për pozitë jashtë loje. Shqipëria tani ka 13 pikë dhe i duhet vetëm edhe një pikë ndaj Moldavisë ose Ishujve Faroe për të siguruar kualifikimin.

Postim i fuqishëm nga Jasir Asani pas fitores bindëse të Shqipërisë ndaj Çekisë

Jasir Asani ka bërë një postim fantastik në llogarinë e tij në Facebook, pas fitores 3-0 të Shqipërisë ndaj Çekisë në kuadër të kualifikimeve për Euro 2024. Ylli shqiptar e hapi llogarinë e golave pas vetëm nëntë minutash, duke realizuar një gol 'bombë' nga distanca.

Asani ka shkruar në rrjetin social se po shkojnë në Berlin, pasi në Gjermani do të mbahet Kampionatin Evropian në vitin e ardhshëm – derisa u duhet vetëm një barazim për të siguruar kualifikimin.

"Guess who is back... Berlin, na

prit!", thuhet fillimisht në shkrimin e tij.

"Fitore e madhe! Fitore e merituar! Ju e meritoni një dhuratë të tillë. Na mbështetët në çdo transfertë e në çdo ndeshje!". "Bashkë, do të ikim në Gjermani! Faleminderit për mbështetjen e jashtëzakonshme dhe motivimin që na keni dhënë. Për Shqipërinë Jeto, Lufto, Fito", përfundon shkrimi i Asanit.



Ndërsa në intervistë për media, Asani ka thënë se që nga fillimi kanë besuar në këtë kualifikim.

"Unë mendoj se që ditën e parë kemi ardhur për një qëllim. Kemi lojtarë shumë të mirë, që po bëjmë shumë mirë. Kemi një staf mjaft profesionist dhe një meritë ka edhe presidenti, që ka bërë një punë shumë të madhe. Kemi ardhur këtu me qëllimin për të shkuar në Evropian dhe me këtë grup, jo vetëm Çekia, por nuk na mundin as kombëtare më të forta", ka thënë mes tjerash ai.

Sylvinho: Duhet edhe pak dhe jemi në Euro 2024

Pas ndeshjes Sylvinho do të shfaqej shumë i lumtur, teksa do të theksonte se ka ende punë për të bërë për të nisur festën.

Ndër të tjera braziliani ka falënderuar tifozët për mbështetjen dhe lojtarët për lojën dhe mentalitetin që kanë në fushë.

"Me shumë vuajte sigurisht. Dua të falënderoj të gjithë tifozët që ishin në stadium. Ishin mbi 22 mijë tifozë që po na shihnin. Ishte një ndeshje e luftuar, por jam i bindur se bëmë një sfidë

perfektë.

Ndeshja me Bullgarinë do të fitojmë njëjtë? Sigurisht do të punojmë fort për një tjetër rezultat pozitiv. Gjithsesi Çekia sot ishte një skuadër e fortë pavarësisht se ne fituam 3-0. Ky është një grup që bëhet i fortë çdo ditë e më shumë. Uzuni, Muçi, Seferi apo të tjerë, janë lojtarë që e kërkojnë shumë sulmin dhe kjo është karakteristikë e tyre.

Sa % jemi në Evropian? Kemi bërë një hap të rëndësishëm, por nuk kemi ende për të bërë. Ndeshje dhe fitore e rëndësishme. Nuk ka mbaruar asgjë dhe me besim plotë kthejmë vëmendjen te sfidat e nëntorit.

Përqafimet me lojtarët dhe besimi ndaj tyre? Kjo është shumë e rëndësishme. Për mua marrëdhënia me lojtarët është mbi gjithçka, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të arrish të ndërtosh një ekip të fortë dhe konkurrues ku atmosfera të jetë pozitive dhe të shkojmë drejt rezultateve. Ishte shumë e bukur të shikoje një skuadër me shpirt gare dhe të gjithë lojtarët ishin në një natë fantastike.

Ne po ndërtojmë diçka shumë të rëndësishme. Kemi ende rrugë dhe punë, por deri tani kemi bërë gjërat që kemi bërë deri tani.

Goditjet nga distance janë pikë e fortë e kombëtares? Ka të bëjë me karakteristikat e lojtarit siç janë Asani, uzuni, Seferi, Bajrami, Asllani dhe ne kemi lojtarë që e ditë mjaft mirë këtë gjuhë,

13 pikë, sa llogari ke bërë me vetën tendë kur u hodh shorti? Uhhh... Ne kemi ende ndeshje për të luajtur dhe na duhet sërish pikë për të arritur në finish. Prisi se kemi edhe dy ndeshje mjaft të rëndësishme dhe ne na duhen sërish pikë. Kjo skuadër ka mentalitet fituesi".

Kosova merr fitoren e parë dhe të vonshme në kualifikimet për Euro 2024 – mposht Andorën

ANDORA, 12 TETOR - Kosova ka marrë fitoren e parë në kualifikimet e Euro 2024, duke triumfuar 3-0 në udhëtim te Andorra, në kuadër të Grupit I Ndeshjen më mirë e nisën tanët, me Florian Loshajn që kishte një goditje nga gjuajtja e lirë qysh në minutën e parë.

Edhe pse ndeshja pati një ritëm të qetë, këtë gjë e ndryshoi Milot

Rashica në minutën e 26-të, duke shënuar një gol të bukur nga asistimi i Florent Muslijës.

Andorra kishte një mundësi shënimi në minutën e 37-të, por që Aro Muric ishte i sigurt.

Pjesa e dytë ishte edhe më dominuese nga Dardanët, duke shënuar dy gola të tjerë.

Ishte minuta e 71-të e takimit, kur Milot Rashica dyfishoi epërsinë,

duke shfrytëzuar gabimin e portierit kundërshtar.

Për 3-0 u përkujdes Altin Zeqiri (83'), që ishte goli i tij i parë në fanellën e Kosovës, ndërsa Rashica ishte asistuesi.

Kosova me këtë fitore shkon në kuotën e shtatë pikë, shtatë më pak se lideri Zvicra, Rumania me 13, Izraeli me 11, Bjellorusia me pesë dhe Andorra me dy pikë. /Telegrafi/



Krasniqi në janar mund të luajë në Serinë A

PRISHTINË, 12 TETOR - Bologna është klubi që ka treguar interesim për transferimin e Ermal Krasniqit nga skuadra rumune e CFR Cluj, ka raportuar gazeta rumune "Prosport". Sipas asaj që është raportuar, aktualisht janë duke u

diskutuar detajet monetare, ku skuadra rumune e llogaritë Krasniqin në vlerë prej pesë milionë euro dhe lëvizja e mundshme mund të bëhet në afatin kalimtar të janarit. Rumunët mund të propozojnë që italianët

ta marrin Krasniqin në huazim për gjashtë muaj, për një milion euro dhe pjesën tjetër të shumës së transferimit ta paguajnë në verën e vitit të ardhshëm. Aktualisht Bologna gjendet në pozitën e njëmbëdhjetë në Serinë A.



FFK-ja: Blerësit e biletave Kosovë - Izrael do të rimbursohen

PRISHTINË, 12 TETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka njoftuar që personat që kanë blerë biletat për ndeshjen Kosovë - Izrael do të rimbursohen. "Pas njoftimit të UEFA-s për shtyrjen për kohë të pacaktuar të ndeshjes ndërmjet Kosovës dhe Izraelit, në kuadër të Grupit I për kualifikimet 'Euro 2024', e planifikuar të zhvillohej më 15 tetor në stadiumin 'Fadil Vokrri' për shkak të situatës së krijuar së fundmi në Izrael, ku është

shpallur gjendje lufte, FFK informon të gjithë personat të cilët kanë blerë biletat për këtë ndeshje, se mjetet do t'u rimbursohen automatikisht në periudhën kohore brenda 7 ditësh, në llogaritë bankare përmes së cilave i kanë blerë biletat. Në rast se pas 7 ditësh ju nuk i keni pranuar mjetet në llogari, ju lutem kontaktoni në email: bileta@t-ticket.al ose tickets@ffk-kosova.com, ka njoftuar FFK-ja.



Rinovime dhe klauzolë 1 miliard euro, Real Madridi "blindon" yjet e mesfushës



MADRID, 12 TETOR - Eduardo Camavinga dhe Federico Valverde është thënë se kanë nënshkruar marrëveshje të reja me Real Madridin, duke përfituar rritje të konsiderueshme të pagës. Sipas një raporti të "COPE", mesfushori francez Eduardo Camavinga ka arritur një marrëveshje për të qëndruar në "Santiago Bernabeu" deri në vitin 2028. Camavinga do të ketë një rritje të konsiderueshme të pagës dhe klauzola e tij e lirimit do të rritet në 1 miliard euro, duke shmangur çdo interesim të mundshëm nga klubet e tjera. Mesfushori 20-vjeçar është bërë pjesë integrale e planeve të Carlo

Ancelottit dhe është paraqitur në 11 ndeshje deri më tani këtë sezon duke grumbulluar 645 minuta lojë. Partneri i mesfushës së Camavinga, Valverde, gjithashtu ka nënshkruar një marrëveshje të re deri në vitin 2028, një zgjatje njëvjeçare nga kontrata e tij aktuale e cila do të skadojë në vitin 2027. Uruguaiani do të ketë klauzolë lirimi prej 1 miliard eurosh, e cila nënvizon statusin e tij si titullar i padiskutueshëm në Real Madrid. Ashtu si Camavinga, ai gjithashtu ka bërë 11 paraqitje, por ka luajtur dukshëm më shumë minuta (838) dhe ka shënuar një gol dhe ka dhënë tri asistime këtë sezon.

Barcelona nuk bëhet rehat, katalanasit këtë herë probleme me "Nike"

BARCELONË, 12 TETOR - Barcelona aktualisht ka disa probleme me të cilat po përballlet dhe nuk janë aspak të lehta. Veçanërisht, klubi vazhdon të vuajë nga problemet financiare, ndërsa është në mes të një beteje gjyqësore për çështjen Negreira. Krahasuar me këto, problemet me aksionet e klubeve duken mjaft të vogla, por është një problem që po bëhet gjithnjë e më

zhgënjyes. Sipas "Mundo Deportivo", fanella kryesore e Barcelonës po shitet pothuajse në çdo madhësi për të rriturit, me përjashtime të vetme që janë mëngë të shkurtra "XXL" dhe disa madhësi me mëngë të gjata. Në sytë e Barcelonës problemi sillet rreth furnizuesit të tyre, kompanisë "Nike". Klubi mendon se kompania nuk është në përputhje me

programin që është miratuar muaj më parë nga vetë klubi, i njohur si Licencimi dhe Merchandising. Barcelona nuk do të ketë fanella të mjaftueshme në dyqan deri më 23 tetor, të hënën e javës së "El Clasicos". Shitjet e tyre janë një ndihmë e madhe për klubin në përpykjen e tyre për t'i zgjidhur problemet financiare, kështu që zhgënjimet e klubit për këtë janë të kuptueshme.





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT NË PRIZREN

Nr. 1920/23
Datë: 12.10.2023

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës në Republikën e Kosovës Nr. 03/L-212, Udhëzimit Administrativ nr. 07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 05/2015 normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional, Udhëzimit Administrativ MASHT Nr. 01/2022, Komuna e Prizrenit, shpall:

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS (ME KOHË TË PA CAKTUAR)

1. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për mësim klasor

Numri i Pozitave: 3

Në shkollat:

SHFMU “Besim Nrecaj” në Lutogllave
SHFMU “Motrat Qiriazit” në Prizren
SHFMU “Dy Dëshmorët” në Piranë

Kualifikimi i kërkuar:

- Fakulteti i Edukimit – programi fillor
- Fakulteti i mësuësishë

2. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për Gjuhë Shqipe

Pozitave: 1

Në shkollat:

SHFMU “Mustafa Bakiu” në Prizren për 8 orë, SHFMU “Lidhja e Prizrenit” në Prizren për 8 orë, dhe në Gjinnazin “Remzi Ademaj” në Romajë 4 orë.

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

3. Titulli i vendit të punës: Matematikë

Numri i Pozitave: 2

Në shkollat:

SHFMU “Mid’hat Frashëri” në Krajk për 12 orë
SHFMU “Mid’hat Frashëri” në Krajk për 20 orë

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

4. Titulli i vendit të punës: Violinë

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

SHMLM “Lorenc Antoni” në Prizren

Kualifikimi i kërkuar:

- Master i muzikës (studimet e kompletuara për instrumentin përkatës)

5. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për lëndë ekonomike

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

IAAP “Ymer Prizreni” në paralelet e ndara fizike në Gjonaj dhe Romajë

Kualifikimi i kërkuar:

- MSc. i ekonomisë - profilit përkatës;
- Ekonomist i diplomuar banka, financa, kontabilitet;
- Ekonomist i diplomuar përgjithshëm.

6. Titulli i vendit të punës: Gjeografi

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

Gjinnazi “Remzi Ademaj” në Romajë për 8 orë dhe Velezhë 4 orë

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

7. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për lëndë Mjekësore

Numri i Pozitave: 3

Në shkollat:

SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren – 2 mësimdhënës me nga 20 orë
SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren, një mësimdhënës për 10 orë mësimore

Kualifikimi i kërkuar:

- Mjek specialist
- Mjek

8. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për Instruktor të praktikës profesionale

Numri i Pozitave: 3

Në shkollat:

SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren – 3 pozita

Kualifikimi i kërkuar:

- Bachelor,
- Instruktorët profesional me kualifikim post sekondar, arsim të mesëm të lartë, teknik etj. me së paku pesë vite përvojë pune në profesion.

9. Titulli i vendit të punës: Histori

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

SHFMU “Zenun Çoçaj” në Gjonaj për 16 orë mësimore

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

KONKURS PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS (ME KOHË TË CAKTUAR)

1. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për Gjuhë Shqipe

Pozitave: 4

Në shkollat:

SHFMU “Motrat Qiriazit” në Prizren – 2 pozita
SHFMU “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” në Mazrek
SHFMU “Ibrahim Fehmiu” në Prizren (pozita e pezulluar)

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

2. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për Gjuhë Angleze

Pozitave: 2

Në shkollat:

SHMU “Gani Saramati” në Prizren për 12 orë dhe 10 orë në SHFMU “Fatmir Berisha” në Prizren (pozita e pezulluar)
Gjinnazi “Remzi Ademaj” në paralelet e ndarë fizike në Gjonaj

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

3. Titulli i vendit të punës: Histori

Numri i Pozitave: 3

Në shkollat:

SHFMU “Gjergj Kastrioti Skenderbeu” në Mazrek (pozita e pezulluar)
SHFMU “Shtjefën Gjeqovi” në Zym 15 orë mësimore (pozita e pezulluar)
SHFMU “Dëshmorët e Hasit” në Kabash për 8 orë histori dhe 5 orë Edukatë Qyterate si dhe plotësim të orëve mësimore në SHFMU “Fatmir Berisha” në Prizren (pozita e pezulluar)

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

4. Titulli i vendit të punës: Gjeografi

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

SHFMU “Xhevat Berisha” në Prizren

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

5. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për mësim klasor

Numri i Pozitave: 3

Në shkollat:

SHFMU “Vëllezërit Frashëri” në Planëjë paralela e ndarë fizike në Gorozhup (pozitë e pezulluar)
SHF “Abdyl Frashëri” në Prizren (pozitë e pezulluar)
SHFMU “Mushnikova” në paralelet e ndarë fizike në Gomjë Sellë

Kualifikimi i kërkuar:

- Fakulteti i Edukimit – programi fillor
- Fakulteti i mësuësishë

6. Titulli i vendit të punës: Edukatë muzikore

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

SHMU “Dëshmorët e Zhurit” në Zhur

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master – Pedagogji e përgjithëshme muzikore (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor – pedagogji e përgjithëshme muzikore (240 ECTS)

7. Titulli i vendit të punës: TIK

Numri i Pozitave: 4

Në shkollat:

SHFMU “Pjetër Budi” në Lubizhdë
SHFMU “Motrat Qiriazit” në Prizren – 2 pozita
Gjinnazi “Remzi Ademaj” në Prizren për 10 orë deri më datë 31.08.2024.

Kualifikimi i kërkuar:

- Programi / dega teknologji-informatikë;
- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

8. Titulli i vendit të punës: Edukatë fizike

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

Gjinnazi “Remzi Ademaj” në Prizren për 16 orë mësimore (pozitë e pezulluar)

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

9. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për lëndë Mjekësore

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

SHMLM “Luciano Motroni” në Prizren

Kualifikimi i kërkuar:

- Mjek specialist
- Mjek

10. Titulli i vendit të punës: Hoteleri

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

IAAP "Ymer Prizreni" në Prizren

Kualifikimi i kërkuar:

- Msc. i turizmit dhe hotelerisë
- Ekonomisi i diplomuar i turizmit dhe hotelerisë

11. Titulli i vendit të punës: Mësimdhënës për Gjuhë Gjermane

Pozitave: 1

Në shkollat:

SHFMU "Motrat Qiriazit" në Prizren

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor- Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

12. Titulli i vendit të punës: Matematikë

Numri i Pozitave: 1

Në shkollat:

SHFMU "Bajram Curri" në Romaje (pozite e pezulluar)

Kualifikimi i kërkuar:

- Niveli master arsimor - Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
- Sistemi katërvjeçar
- Baçelor (katërvjeçar 240 ECTS)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgatit planet e lëndës në bazë vjetore, mujore, javore dhe ditore të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- Mban orën mësimore sipas orarit të paracaktuar
- Planifikon, vëzhgon, mbikëqyr dhe udhëheq nxënësin dhe sjelljen e secilit nxënësi,
- Zbaton metodologji të reja të mësimdhënies dhe vlerësimit,
- Kujdeset dhe ndjek zhvillimin profesional-trajnimet,
- Koordinon punën sipas kërkesave të administratës së shkollës;
- Organizon aktivitete jashtëshkollore;
- Merr pjesë në të gjitha aktivitetet dhe ngjarjet e shkollës;
- Përgatit raportet e nevojshme, për nevojat e administratës së shkollës;
- Komunikon dhe bashkëpunon me prindërit dhe nxënësit e shkollës, kolegët dhe administratën;
- Bashkëpunon dhe merr pjesë në punën e organeve të shkollës, në organizimet e shkollës, dhe aktivitetet ekstrakurikulare;
- Kryen edhe punë të tjera të lidhura me aktivitetin mësimor të caktuara nga drejtori bazuar në legjislacionin në fuqi, Rregulloret, Udhëzimet Administrative.

Dokumentacioni i kërkuar:

(në kopje fizike)

- Fotokopja e Letërnjoftimit
- Diploma e Fakultetit (kopja e noterizuar)
- Nostifikimi, nëse kandidati e ka kryer shkollimin jashtë Kosovës
- Referenca për rezultatet në punë (nëse posedon)
- Trajnimet profesionale
- Ekstrakti i lindjes

Dokumentet që do të kërkohen për kandidatët të cilët përzgjidhen

- Vërtetimi/dëshmia se kandidati nuk ka qenë i dënuar për krim, dhunë ose vepër të padenjë që përfshinë fëmijët.
- Certifikatën shëndetësore të lëshuar nga një institucion publik shëndetësor, me të cilën dëshmohet gjendja e tij/saj shëndetësore (kandidati/ja e sjell pas përzgjedhjes sipas procedurës.
- Të gjitha dokumentet origjinale kandidati/ja i/e përzgjedhur i sjellë për verifikim sipas procedurave.
- Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë kalendrike nga data 13.10.2023 deri më 27.10.2023 që konsiderohet si dita e fundit dhe mbyllja e konkursit.
- Aplikimet e dorëzuara pas afatit të parashikuar nuk pranohen dhe aplikimet me mangësi refuzohen.
- Aplikacioni për konkurim merret në zyrat e DKA-së. Pas plotësimit sipas çdo pike të aplikimit, bashkëngjiten dokumentet të cilat kërkohen sipas konkursit dhe mund të aplikoni në DKA.
- VËMENDJE: Aplikimet e pranuar pas afatit të përcaktuar konsiderohen të pranueshme, nëse data në dërgesën postare, ose çfarëdo dëshmie tjetër për datën e dërgimit, dëshmon se ajo është dërguar brenda afatit të dorëzimit të aplikimeve. Konkursi është i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar, pa asnjë lloj diskriminimi ashtu siç parashikohet nga Ligjislacionin në fuqi. Konkursi dhe rezultatet shpallen në web faqen e Komunës së Prizrenit.

Drejtorja e Arsimit në Prizren
Drejtoresha/Luljeta Veselaj Gutaj


NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Doner Aksaray" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrB UNIK: 811932765 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditore nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Doner Aksaray" D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrB. 811932765 ujedno imenovao Likvidat3ora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Doner Aksaray" L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 811932765 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Dr. Shyqri Jëlliçi, shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës, me nr. KO-03842-01-08.

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

U bënë 15 vjet nga ndarja e më të dashurit tonë



Milaim H. Misini

(20.04.1938-13.10.2008)

Vdekja të ndau nga Jeta, por jo nga zemrat tona.

E përkujtojnë: *Familja Misini nga Prishtina dhe Korretica e Ulët*

